

# SË BASHKU REALIZOJMË



# ËNDËRRAT TONA

# DEMOKRACIA - ZËRI I POPULLIT

ADEA (10), AULONA (10), BULZA (10), DIANA (11), ERIN (10), ENSAR (11), LEJLA (11), SARA (11),

YLL (11)

**Demokracia është përditshmëria jonë. Ajo është dielli dhe oksigjeni ynë, sepse falë saj ne si fëmijë rritemi dhe edukohemi**

Demokracia është forma më e mirë e qeverisjes. Ajo i mundëson çdo individ të vendos për të ardhmen e vet. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. E tëra kjo, nënkupton qeverisjen e popullit. Nga titulli mund të kuptoni sado pak rëndësinë e kësaj teme, sepse demokracia me të vërtetë është zëri i popullit. Është populli ai, i cili vendos për të ardhmen e vendit. Këtë e bën përmes një të drejte shumë të rëndësishme, siç është e drejta e votës. Të drejtën e votës e gëzon çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare. Pra, në një farë mënyre, ne bëhemi pjesë e bashkëqeverisjes.



Përgjegjësi e jona është po ashtu edhe bashkëpunimi brenda grupit tonë



Në këtë vizatim kemi paraqitur një të drejtë shumë të rëndësishme për të gjithë njerëzit



E drejta e fjalës së lirë, është një ndër të drejtat kryesore që njerëzit në demokraci e gëzojnë

Megjithatë, ne edhe si fëmijë që jemi mund të kontribuojmë shumë për demokracinë. Këtë e bëjmë duke mësuar, duke qenë të përgjegjshëm, duke qenë të arsyeshëm, duke qenë solidarë, etj. Këto gjëra ne mund t'i bëjmë për demokracinë, sepse edhe demokracia bën shumë gjëra të mira për ne.

Demokracia ndahet në dy forma: në demokracinë përfaqësuese dhe atë të drejtpërdrejtë. Në demokracinë përfaqësuese, vendimet dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme merren nga ana e përfaqësuesve të popullit, të cilët janë deputetët. Ndërsa, në demokracinë e drejtpërdrejtë, si vendimet ashtu edhe çështjet e tjera merren direkt nga ana e popullit. Pra, në demokraci çdo njeri ka vlerën e vet.




Bota është e mbushur me njerëz të mirë dhe të mençur



## KUVENDI DHE FUNKSIONET E TIJ

ELJESA H. (11), ERION SH. (10), ERION A. (11), ERMIR (11), ALMA (10), FJOLLA (10), ELESZA ZH. (10),  
FINESA (10), JONA (10)




### Në këtë artikull ne kemi përgatitur disa shkrime dhe disa vizatime për Kuvendin e Kosovës. Ju lutem, nëse dëshironi të dini më shumë për këtë temë, atëherë lexojeni artikullin tonë

Ne e njohim një djalosh, i cili quhet Astrit. Ai ka 24 vjet dhe ka dëshirë të bëhet deputet. Mirëpo, ai nuk di se ku duhet të shkoj të kandidoj. Megjithatë, ne e dimë se ai duhet të shkoj tek KQZ, apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Aty duhet të shkruaj emrin dhe të dhënat e tij në listën e kandidatëve për deputetë. Pasi Astriti kandidon, ai merr pjesë në zgjedhjet parlamentare. Për t'u bërë një deputet i Kuvendit të Kosovës ai duhet të marrë shumë vota të qytetarëve. Në Kuvend punojnë 120 deputetë. 100 prej këtyre deputetëve janë shqiptarë, ndërsa 20 të tjerë iu takojnë komuniteteve jo shumicë të Kosovës. Kuvendi i Kosovës, ashtu siç bi-

seduam, ka tri funksione kryesore. Ato janë: funksioni përfaqësues, legjislativ, dhe ai i kontrollit. Funksioni përfaqësues do të thotë se deputetët, të cilët punojnë në Kuvend, i kanë marrë votat nga populli dhe ata kanë për detyrë të përfaqësojnë qytetarët. Funksioni legjislativ rrjedh nga fjalët „ligj“ dhe „vënës“, që do të thotë se Kuvendi ka për detyrë të vendos ligje të reja. Në fund, kemi funksionin e kontrollit, që do të thotë se Kuvendi duhet ta kontrollojë punën e Qeverisë së Kosovës. Prandaj, për këtë arsye në seancat plenare janë të pranishëm edhe Kryeministri dhe ministrat e Qeverisë, të cilët edhe propozojnë ligje tek Kuvendi. Sikurse Kuvendi që vendos rregulla dhe ligje të cilat ne duhet t'i respektojmë, ashtu edhe ne nëse shpikim ndonjë lojë, duhet të vendosim rregulla të lojës dhe të kujdesemi që secili prej nesh t'i respektojë ato.



Nxënësit e grupit të tretë




Vizatimi ynë i Kuvendit të Kosovës

## ZGJEDHJET DHE LIGJET NË DEMOKRACI

SELATIN (11), DRIN (10), FATLUM (10), ENES (10), ZARIFE (11), BLERINA (10), BLERANDA (11),


ALMIRA (11), ERIONA (11)



### Zgjedhjet që i bëjmë në jetën e përditshme

Demokracia mundëson që ne të kemi liri dhe të drejta të barabarta, mirëpo prapëseprapë duhet të jemi tolerantë me njëri-tjetrin.

Ne kemi lirinë e shprehjes së mendimit dhe lirinë e zgjedhjes. Kur zgjohemi në mëngjes kemi të drejtën e zgjedhjes së rrobave dhe ushqimit që dëshirojmë të konsumojmë. Po ashtu, kemi të drejtën e zgjedhjes së instrumentit që dëshirojmë të luajmë, të zgjedhjes së librit që na pëlqen ose që duam ta lexojmë, të zgjedhjes së sportit ose lojës që dëshirojmë ta luajmë, etj. Sof në grupin tonë, secili prej nesh kishte të drejtën e shprehjes së mendimit. Gjithashtu, kemi kuptuar se disa nga të drejtat tona në demokraci janë: e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e familjes, e drejta e strehimit, e drejta e kujdesit shëndetësor, e drejta e emrit, etj.



Të gjithë kemi të drejta të barabarta

### Zgjedhjet në demokraci


Populli zgjedh përfaqësuesit në procesin zgjedhor. Përfaqësuesit, të cilët populli i voton në Kosovë janë deputetët.

Ka dy lloje të zgjedhjeve, të cilat janë: zgjedhjet parlamentare dhe ato komunale. E drejta për të votuar në këtë proces fillon nga moshja 18 vjeçare, sepse atëherë qytetarët janë më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për vendimet që i marrin. Në zgjedhjet komunale, qytetarët votojnë për asambleistët dhe për kryetarin e komunës. Kurse në zgjedhjet parlamentare, populli voton për deputetët si përfaqësues të vendit.


Votimet mund të jenë të hapura ose të mbyllura. Në klasën tonë, ne e kemi zgjedhur kryetarin e klasës me votim të hapur. Mirëpo, pasi që zgjedhja e deputetëve është shumë e rëndësishme dhe nuk duhet të ketë manipulime, atëherë votimi është i mbyllur.



Ne ndikojmë në të ardhmen tonë



Rregullat në komunikacion




Të drejtat e njeriut

**Ligjet rregullojnë jetën tonë**

Ligjet janë rregulla që qytetarët duhet t'i respektojnë. Ligjet në demokraci janë të rëndësishëm, sepse rregullojnë jetën tonë. Pa ligje, jeta jonë do të ishte kaos. Nëse ligjet nuk respektohen, atëherë pasojnë dënimet. Ligjet të cilat propozohen, bazohen në Kushtetutën e vendit, i cili është akti më i lartë juridik i shtetit. Për të kuptuar më mirë ligjet, marrim një shembull: nëse ne jemi duke ngasur një makinë dhe para nesh është një tabelë e komunikacionit, e cila tregon kufirin e lejuar të shpejtësisë, ne duhet ta respektojmë atë rregull dhe ta përshtasim shpejtësinë. Nëse rregulla nuk respektohet, atëherë mund të ndodhin aksidente. Këto ishin disa informata dhe shembuj për ligjet në demokraci. Grupi ynë shpreson që ju e keni kuptuar rëndësinë e ligjeve në jetën tonë.



Grupi „9 vjeçar“



Respektimi i ligjit



E drejta e kujdesit shëndetësor





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Naim Frashëri“  
Klasa: V-3  
Vendi: Vushtrri